

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
“AGJENSIA IME” SHPK

Sot ne daten 02/01/2025, ortaku themelues :

Zanola Taragjini, e datelindjes 20.03.1992, lindur ne Grabovë, Shqiperi, banues ne Durres, e pajisur me leternjoftimin me nr.personal J25320097T.

Ne baze te ligjit nr . 9901 date 14.04.2008 ‘Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ‘ dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 ‘Per qendren kombetare te regjistrimit ‘ kemi vendosur te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “AGJENSIA IME” SHPK.

Neni 1 :

Emertimi i shoqerise

Shoqeria do te quhet “AGJENSIA IME” SHPK dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti , ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si edhe ligjit per QKR.

Neni 2

Selia e shoqërisë

Shoqeria do te kete seline e saj ne Lagjja nr. 11, Rruga Deshmoret, Dyqani nr. 2,Durres. Shoqeria mund te krijoje dege , filiale , zyra përfaqësim ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj: Agjensi udhetimi.

Neni 4

Kapitali i shoqërisë

Kapitali i shoqërisë “AGJENSIA IME” Shpk do te jete 100.000 Leke .

Ky kapital perbehet nga 1 kuot dhe zoterohet ne masen 100% nga ortaku ZANOLA TARAGJINI.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periodhe kohore te pacaktuar .

Neni 6

Organet e shoqerise

1.Asambleja e përgjithshme

2.Administratori

Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

ADMINISTRATORI

Administrator i shoqerise do te jete Znj. ZANOLA TARAGJINI, e datelindjes 20.03.1992, lindur ne Grabovë, Shqiperi, banues ne DURRES, e pajisur me leternjoftimin me

nr.personal J25320097T e cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte riprteritje te ketij afati.

Administratori mund te shkarkohet ne do moment nga asambleja, me shumice te thjeshte te votave, me kusht që ne mbledhje të marrin pjesë ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% të kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtone apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

Shperndarja e fitimit vjetor të shoqerise

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakëve pjesën e fitimit ne raport me vleren e kapitalit të regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 8

Prishja e shoqerise.

Shoqeria priset :

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b)me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit,
- ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "OKR",
- d) me vendim te giykates,
- dh) per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

NENI 9

Likuidimi i shoqerise.

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emerone nje likuidator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e progesit te likuidimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 10

Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershtohet pas cregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

ZANOLA TARAGJINI

